REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës:	2021:016460
Datë:	03.12.2021
Numri i dokumentit:	02469762

C.nr.111/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Afijete Sada – Gllogjani, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses V. T. nga Gjakova, përfaqësuar nga Fadil Sinanaj avokat në Gjilan, rruga "Bulevardi i Pavarësisë" H-35, k-2, nr. 4, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" - Gjakovë, rruga "Dëshmorët e Lirisë", i përfaqësuar nga V.R. me autorizim në lëndë, kontest pune, pagesë e shpërblimeve jubilare, vlera e kontestit 1,129.89 euro, pas përfundimit të shqyrtimit përgatitor – publik, të mbajtur me 15 nëntor 2021, në të cilin morën pjesë të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me 03 dhjetor 2021, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses V. T. nga Gjakova dhe DETYROHET i padituri Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, t'ia paguaj shumën tri paga mujore në shumë prej 1,129.89 euro (një mijë e njëqind e njëzetë e nëntë euro e tetëdhjetë e nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 15 nëntor 2021, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269.00 euro (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të ekzekutimit tw dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar padi kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, me bazë juridike - kompensim i shpërblimit jubilar. Paditësja është në marrëdhënie pune tek i padituri në punët dhe detyrat e punës: Infermiere në Shërbimin e Terapisë Fizikale në Spitalin e Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, ku aktualisht i ka bërë 30 vite përvojë pune tek i padituri. Paditësja disa herë me kërkesë verbale iu ka drejtuar të paditurit për realizimin e pagesës në raport me shpërblimin jubilar, por deri me tani e njëjta nuk i është përgjigjur, andaj kërkesa e paditëses është e parashtruar konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale në nenin 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të tre pagave mujore dhe atë shumën e përgjithshme prej 1,129.89 euro, pasi që një pagë mujore është në shumë prej 376.63 euro.

Në rastin konkret ka kundërshtuar në tërësi përgjigjen në padi si të pabazuar.

2021:016461

I autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimi ka deklaruar se pas administrimit të provave konsiderojmë se është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë, ashtu që nga kontrata e punës është vërtetuar fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar, nga vërtetimi i marrëdhënies së punës, është vërtetuar fakti se paditësja ka mbi 30 vite përvojë pune dhe nga lista e pagës është vërtetuar fakti se paditësja pagën mujore neto e ka realizuar prej 676,63 euro (nga e cila hiqet shtesa emergjente Covid 19 në shumë prej 300.00 euro), ashtu që kërkohet shkuma prej 376.63 euro. Pas vlerësimit të këtyre provave ka kërkuar nga gjykata që në tërësi të e aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar në legjislacionin në fuqi dhe të e detyrojë të padituren që paditëses të ia paguaj shpërblimin jubilar, në shumë prej 1,129.89 euro në vlerë të shpërblimit jubilar dhe atë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive.

Në rastin konkret ka kundërshtuar në tërësi përgjigjen në padi si të pabazuar.

Shpenzimet procedurale ka kërkuar për taksë gjyqësore në shumë prej 30.00 euro, për përpilim të padisë shumën prej 104.00 euro, për përfaqësim në seancë shumën 135.00 euro.

I padituri në përgjigje në padi ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për arsye se kompensimi i pagave jubilare nuk është bërë për arsye të mungesës se mjeteve buxhetore dhe se nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, nuk është paraparë vija buxhetore për këtë kategori, andaj në mungesë të kësaj linje buxhetore përkatësisht mungesës së mjeteve financiare, Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, nuk ka mundësi objektive për t'a përmbushur obligimin e kompensimit të pagave jubilare për faktin se veprimi në drejtim të kompensimit të tyre është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Me propozim për gjykatën që t'a refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pathemeltë.

E autorizuara e të padituri gjatë shqyrtimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e palës paditëse, paditësja në fjalë ka realizuar shpërblimin jubilar për 20 vite përvojë pune në bazë të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PP.nr.433/20, të datës 09 korrik 2021 dhe propozuar që padia dhe kërkesa e saj të refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin përgatitor-publik, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Kontratën e punës të datës 01 janar 2013, vërtetimin e marrëdhënies së punës, datë 18 janar 2021, listës së pagave të muajit nëntor 2020 si dhe letërnjoftimin e paditëses me nr. ID . . ., me ç'rast pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, rrethanave jo kontestuese mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për procedurën kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e zbatuara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Në mes të autorizuarve të palëve në procedurë, nuk është kontestuese rrethana se paditësja ka realizuar dy paga jubilare si shpërblim për 20 vite përvojë pune, para se të arrijë 30 vite përvojë pune, si dhe fakti se paditësja ka 30 vite përvojë pune.

Me Kontratën e punës, nr. prot. . . , datë 31 dhjetor 2012, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurin Spitali Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, në detyrat e punës: Infermiere në Shërbimin e Terapisë, duke filluar nga data 01 janar 2013.

Nga vërtetimi, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, datë 18 janar 2021, është provuar rrethana se paditësja është e punësuar tek i padituri Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, si Infermiere në Shërbimin e Terapisë prej datës 11 prill 1994 e tutje.

Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e cila i referohet muajit nëntor 2020, vërteton rrethanën se paditësja ka 30 vite përvojë pune dhe realizon pagë mujore në vlerë prej 676.63 euro (me 300.00 euro shtesë nga pako emergjente Covid-19).

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësja është e punësuar tek i padituri për më shumë së 30 vite, e që prej kohës kur i ka mbushur 30 vite përvojë pune, të njëjtës nuk i është bërë pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të tre pagave mujore, të parapara me nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e këtyre pagave e ka pohuar edhe i padituri përmes përgjigjes në padi, duke pretenduar se i padituri nuk ka linje buxhetore të paraparë për këtë kompensim.

Lidhur me bazën e kërkesëpadisë Gjykata vendosi duke ju referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3, është paraparë se: "Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë […] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të tre pagave mujore të tij". Përvojën e punës së paditëses gjykata e vërtetojë nga vërtetimi, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë, datë 18 janar 2021, ndërsa lartësinë e pagesës mujore e vërtetojë në listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, duke e zbritur vlerën 300.00 euro, nga pako emergjente Covid 19, në shumën prej 676.63 euro (676.63 euro – 300.00 euro = 376.63 euro), ku erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, duke ia njohur shumën prej 1,129.89 euro, me përllogaritje si në vijim (376,63x3=1,129.89).Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (KKS) është e aplikueshme në rastin konkret, e njëjta ka hyrë në fuqi me 11 qershor 2018 dhe është e zbatueshme.

Në nenin 17 paragrafi 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë parashihet se "Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilare. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf". Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i padituri, së këndejmi, paditësja ka rolin e kreditorit kurse i padituri rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, parashihet se "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij". Rrjedhimisht, duke qenë se i padituri i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të padituren që paditëses t'ia kompensoj shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurit të dhënë në përgjigje në padi, ku ka theksuar se i njëjti nuk ka linje buxhetore për kompensimin e punëtorëve shëndetësor, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, për shkak se me nënshkrimin e Kontratës Kolektive Sektoriale të shëndetësisë, i

padituri ka marrë obligim që të bëjë kompensimin e këtyre pagave, e po ashtu ka obligim me kohë të planifikoj buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka paraparë linjë buxhetore për këtë lloj të kompensimit.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë", e llogaritur nga data 15 nëntor 2021.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç'rast paditëses iu pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 269.00 euro. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 30.00 euro (sipas Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, dhe përfaqësim në një seancë gjyqësore 135.00 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.111/2021, me 03 dhjetor 2021

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada - Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.